



**tobaccotaxation**  
Economic Research Informing  
Tobacco Taxation Policy

# Përdorimi i Duhanit nga të Rriturit në Kosovë

**Besnik Prekazi MA**  
**Erëza Pula MSc**



**DEMOCRACYPLUS**

Prishtinë, 2020

## MIRËNJOHJE

Demokrasi Plus (D+) është duke punuar në bashkëpunim me Institutin e Shkencave Ekonomike në Beograd, i cili është duke koordinuar një rrjet regional të hulumtuesve në Evropën Juglindore mbi taksat në duhan. Projekti financohet nga Universiteti i Illinois në Çikago (UIC) Instituti për Hulumtime dhe Politika Shëndetësore për të realizuar hulumtime ekonomike mbi taksat në duhan në Kosovë. UIC është partner i Iniciativës Bloomberg për të Zvogëluar Përdorimin e Duhanit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen, as nuk i paraqesin qëndrimet e UIC, Institutit për Kërkime dhe Politika Shëndetësore, apo Filantropisë Bloomberg.

Autorët falënderojnë UIC dhe Qendrat e SHBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) për komentet e dhëna.

Prishtinë, tetor 2020

Citim i sugjeruar: Prekazi, B. & Pula, E. (2020). *Përdorimi i Duhanit te të Rriturit në Kosovë*. Demokrasi Plus. Prishtinë, Kosovë.

## **PËRMBAJTJA E TABELËS**

<b>MIRËNJOHJE</b> .....	<b>2</b>
<b>PËRMBAJTJA E TABELËS</b> .....	<b>3</b>
<b>LISTA E FIGURAVE</b> .....	<b>5</b>
<b>LISTA E TABELAVE</b> .....	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>8</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	<b>11</b>
<b>FJALOR</b> .....	<b>12</b>
<b>1. HYRJE</b> .....	<b>14</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>16</b>
2.1. Popullata e studiuar .....	16
2.2. Modelimi i mostrës .....	17
2.3. Pyetësori i hulumtimit.....	17
2.4 Agjencioni implementues .....	18
2.5. Rekrutimi.....	18
2.6. Paratesti/pilot testi .....	18
2.7. Trajnimi .....	19
2.8. Puna në terren .....	19
2.9. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave .....	19
2.10. Analiza statistikore.....	19
2.11. Koeficienti .....	19
2.12 Karakteristikat e mostrës dhe popullatës.....	20
<b>3. PËRDORIMI I DUHANIT</b> .....	<b>21</b>
3.1. Përdorimi i llojeve të ndryshme të duhanit tymosës .....	22
3.2. Cigaret e konsumuara në baza ditore .....	23
3.3. Fillimi i duhanpirjes në baza ditore .....	24
<b>4. NDËRPRERJA E DUHANIT</b> .....	<b>25</b>
4.1. Raporti i ndërprerjes së duhanit .....	25
4.2. Përpjekjet për ta ndërprerë dhe kohëzgjatja e abstenimit nga konsumimi i duhanit ..	25
4.3. Arsyet e ndërprerjes së duhanpirjes.....	27
4.4. Ndryshimi i intensitetit në konsumimin e duhanpirjes dhe arsyet për ulje të konsumit .....	27
<b>5. DUHANPIRJA PASIVE</b> .....	<b>29</b>
5.1. Ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive në shtëpi .....	29

5.2. Ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive në vendet publike .....	30
5.3. Qëndrimet ndaj ekspozimit të duhanpirjes pasive .....	30
<b>6. EKONOMIA .....</b>	<b>31</b>
6.1. Çmimet e cigareve .....	31
6.2. Shpenzimet për cigare .....	32
6.3. Konsumimi .....	34
6.4. Brendet e cigareve .....	35
6.5. Vendi i blerjes.....	37
6.6. Sjellja e duhanpirësve ndaj ngritjes të çmimit.....	37
<b>7. MEDIAT, QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET .....</b>	<b>39</b>
7.1. Promovimi i duhanit.....	39
7.2. Qëndrimet ndaj çmimit të cigareve .....	40
7.3. Rritja e çmimit të cigareve për pesë përqind.....	41
7.4. Rritja e çmimit të cigareve për 20 përqind .....	41
7.5. Dobia e politikave kundër duhanit.....	42
<b>8. KONKLuzion .....</b>	<b>44</b>
<b>SHTOJCË .....</b>	<b>46</b>

## LISTA E FIGURAVE

- Figura 3.1** Prevalenca e konsumit ditor të duhanit në mesin e burrave është më shumë se dy herë më e lartë sesa te gratë
- Figura 3.2** Intensiteti i pirjes së duhanit është i lartë, pasi që shumica e duhanpirësve aktualë, veçanërisht burrat, konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë
- Figura 4.1** Më shumë se gjysma e duhanpirësve aktualë të cilët janë përpjekur të heqin dorë nga pirja e duhanit i janë rikthyer pas vetëm një muaji
- Figura 4.2** Duhanpirësit më të rinj kanë relativisht më shumë gjasa ta ndërpresin duhanin
- Figura 4.3** Shumica e duhanpirësve aktualë të cilët konsumojnë më pak duhan sesa më parë e bëjnë këtë për arsye shëndetësore
- Figura 5.1** Duhanpirësve të përditshëm shpesh u thuhet se duhanpirja e tyre i bezdisë të tjerët përreth
- Figura 6.1** Në Kosovë çmimi mesatar për 20 cigare të prodhuara është më i lartë sesa për cigaret e mbështjella me dorë
- Figura 6.2** Në përgjithësi, 79.6 përqind e duhanpirësve aktualë shpenzojnë më pak se 100 euro në muaj për prodhimet e duhanit
- Figura 6.2.1** Duhanpirësit burra shpenzojnë përqindje relativisht më të lartë të buxhetit të tyre në cigaret e prodhuara dhe ato të mbështjella me dorë sesa duhanpirëset gra
- Figura 6.3** Duhanpirëset gra konsumojnë rreth nëntë cigare të prodhuara më pak se duhanpirësit burra
- Figura 6.4** Brendet më të konsumuara të cigareve në Kosovë janë Winston, Lucky Strike, dhe Marlboro
- Figura 6.4.1** Shumica e duhanpirësve aktualë janë shumë besnik ndaj brendeve të cilat i konsumojnë
- Figura 6.5** Në Kosovë cigaret e prodhuara më së shumti blihen në dyqane ushqimore
- Figura 6.6** Shumica e duhanpirësve të cigareve të prodhuara nuk e ndryshuan shprehinë e pirjes së duhanit as pas rritjes së fundit të çmimit të cigareve
- Figura 7.1** Vetëm 2.5 përqind e të rriturve kanë parë apo dëgjuar rreth ngjarjeve të sponsorizuara apo që lidhen me brende apo kompani të duhanit
- Figura 7.2** Shumica e të rriturve e perceptojnë çmimin e cigareve si të shtrenjtë apo si shumë të shtrenjtë
- Figura 7.3** Më shumë se 40 përqind e të rriturve janë fuqishëm kundër rritjes së çmimit të cigareve prej pesë përqind
- Figura 7.4** Afërsisht 60 përqind e të rriturve janë jashtëzakonisht ose mesatarisht kundër rritjes së çmimit të cigareve prej 20 përqind
- Figura 7.5** Rritja e çmimit të cigareve dhe përfshirja e pirjes së duhanit si veprimtari ilegale perceptohen si politikat më të dobishme kundër duhanit

## LISTA E TABELAVE

**Tabela 2.1** Madhësia e mostrës, numri, dhe përqindja e popullatës së moshës 18 deri 85, përfaqësimi në terma gjinor, mosha, rajoni dhe lloji i banimit

**Tabela 2.2** Pesha: rajoni i Ferizajt

**Tabela 2.3** Pesha: rajoni i Gjakovës

**Tabela 2.4** Pesha: rajoni i Gjilanit

**Tabela 2.5** Pesha: rajoni i Mitrovicës

**Tabela 2.6** Pesha: rajoni i Pejës

**Tabela 2.7** Pesha: rajoni i Prishtinës

**Tabela 2.8** Pesha: rajoni i Prizrenit

**Tabela 3.1** Shpërndarja e përqindjes së të rriturve sipas frekuencës së pirjes së duhanit të produkteve të duhanit të tymosur, totali dhe sipas karakteristikave të zgjedhura demografike

**Tabela 3.2** Shpërndarja e përqindjes të rriturive duhanpirës aktual, sipas llojit të produkteve të duhanit tymosës

**Tabela 3.3** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve aktual sipas numrit mesatar të cigareve të konsumuara në ditë (10 ose më pak, 11-19, 20+), totali dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 3.4** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve të përditshëm, sipas moshës së fillimit të duhanpirjes së përditshme

**Tabela 4.1** Raporti i ndërprerjes së duhanit

**Tabela 4.2** Kohëzgjatja e ndërprerjes së duhanpirjes (<1 muaj, 1–3 muaj, 3–6 muaj, >6 muaj) nga përpjekja e fundit për ndërprerje në 12 muajt e fundit

**Tabela 4.3a** Duhanpirësit aktual të cilët janë përpjekur ta ndërpresin pirjen e duhanit në 12 muajt e fundit, sipas arsyeve për ndërprerje

**Tabela 4.3b** Duhanpirësit aktualë të cilët janë përpjekur ta ndërpresin pirjen e duhanit në 12 muajt e fundit, sipas metodave të përdorura për ndërprerje

**Tabela 4.4** Intensiteti i duhanpirjes nga duhanpirësit aktualë tani dhe në të kaluarën

**Tabela 5.1** Përqindja e të rriturve të cilët i ekspozohen tymit të duhanit në shtëpi, sipas statusit të duhanpirjes dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 5.2** Përqindja e të rriturve që i janë ekspozuar tymit të duhanit në vende të ndryshme publike

**Tabela 6.1** Shuma mesatare e shpenzuar nga duhanpirësit aktualë në 20 cigare të prodhuara dhe të mbështjella me dorë, sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.2** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve aktualë të produkteve të duhanit sipas mesatares mujore të shpenzimeve në duhan dhe sipas karakteristikave demografike

**Tabela 6.2.1** Shpenzimet mesatare mujore në duhan nga duhanpirësit aktual për cigaret e prodhuara dhe të mbështjella me dorë, sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.2.2** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve aktual sipas shpenzimeve mesatare mujore në të gjitha llojet e duhanit, cigare të prodhuara dhe të mbështjella me dorë, sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.3** Numri mesatar i cigareve të prodhuara dhe të mbështjella me dorë që konsumohen në baza ditore nga duhanpirësit aktual, në total dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.4** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve aktual të cigareve të prodhuara, sipas brendit të fundit të blerë dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.5** Shpërndarja e përqindjes së duhanpirësve aktual të cigareve të prodhuara, sipas vendit të fundit ku kanë blerë cigare dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 6.6** Shpërndarja e përqindjes së reagimit të duhanpirësve aktual ndaj rritjes së fundit të çmimit, sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 7.1** Numri dhe shpërndarja e përqindjes së të rriturve të cilët kanë parë apo dëgjuar, gjatë gjashtë muajve të fundit, rreth ngjarjeve të sponsorizuara nga apo që kanë të lidhshmëri me brendet e cigareve, brendet e e-cigareve apo kompanitë e cigareve, në përgjithësi dhe sipas statusit të pirjes së duhanit

**Tabela 7.1.1** Numri dhe shpërndarja e përqindjes së të rriturve, që kanë vërejtur gjatë gjashtë muajve të fundit, çfarëdo lloji të promovimit të duhanit, në përgjithësi dhe sipas gjinisë

**Tabela 7.2** Shpërndarja e përqindjes së perceptimit të të rriturve ndaj çmimeve të cigareve, në përgjithësi dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 7.3** Shpërndarja e përqindjes së reagimit të të rriturve ndaj rritjes së çmimit prej pesë përqind, në përgjithësi dhe sipas statusit të duhanpirjes

**Tabela 7.3.1** Numri dhe shpërndarja e përqindjes së reagimit të të rriturve ndaj rritjes prej pesë përqind të çmimit të cigareve, në përgjithësi dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 7.4** Shpërndarja e përqindjes së reagimit të të rriturve ndaj rritjes prej 20 përqind të çmimit të duhanit, në përgjithësi dhe sipas statusit të duhanpirjes

**Tabela 7.4.1** Numri dhe përqindja e reagimit të të rriturve ndaj rritjes prej 20 përqind të çmimit të cigareve, në përgjithësi dhe sipas karakteristikave të përzgjedhura demografike

**Tabela 7.5** Shpërndarja e përqindjes së perceptimit të të rriturve ndaj dobive që sjellin politikat e kontrollit dhe kufizimit të duhanit, në përgjithësi dhe sipas statusit të duhanpirjes

## PËRMBLEDHJE

Demokrati Plus (D+) ka realizuar një hulumtim mbi përdorimin e duhanit te të rriturit në Kosovë në kuadër të Hulumtimit mbi Konsumimin e Duhanit në Vendet e Evropës Juglindore (STC-SEE). Ky hulumtim është kryer në gjashtë vende të SEE duke përfshirë Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Hulumtimi është koordinuar nga Instituti i Shkencave Ekonomike (IES) në Beograd dhe financuar nga Universiteti i Illinois në Institutin e Çikagos për Kërkime dhe Politika Shëndetësore (UIC).

Hulumtimi i realizuar nga D+ dhe hulumtime të tjera<sup>1</sup> tregojnë se, varësisht nga burimi dhe metodologjia e përdorur, gjendja mbi përdorimin e duhanit dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik është jo konsistente. Për më tepër, në Kosovë ka mungesë të të dhënave të krahasueshme në nivel rajonal dhe në nivel global mbi prevalencën e pirjes së duhanit dhe aspektet tjera të përdorimit të tij. Për këtë arsye, mbështetur në metodën e asistimit të kompjuterit personal për intervista (CAPI) u realizua një hulumtim në terren në tërë Kosovës. Të gjeturat e këtij hulumtimi ofrojnë të dhëna të rëndësishme për Qeverinë e Kosovës për të vlerësuar politikat e tanishme dhe dizajnuar politika të reja mbi kontrollin e duhanit. Për më tepër, të gjeturat e hulumtimit mund të përdoren për të vlerësuar studimet e mëparshme dhe raportet zyrtare mbi përdorimin e duhanit.

Pyetëtori i STC-SEE është bazuar në pyetëtorët e tri hulumtimeve ekzistuese globale: Hulumtimi Global i Duhanit te të Rriturit (GATS),<sup>2</sup> Hulumtimi i Kontrollit Ndërkombëtar të Duhanit (ITC),<sup>3</sup> dhe Hulumtimi i Politikave të Çmimeve dhe Kontrollit të Duhanit në Evropë (PPACTE)<sup>4</sup>.

Mostra e këtij hulumtimi në Kosovë përbëhet nga 1,000 të rritur të moshës 18 deri 85 vjeç, e cila është dizajnuar për të përfaqësuar tërë vendin bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, në vitin 2011. Qëllimi i hulumtimit ishte mbledhja e informacioneve nga respondentët mbi karakteristikat e tyre biografike, përdorimin e duhanit dhe ndërprerjen e duhanit (të gjitha llojet), duhanpirjen pasive, ekonominë e duhanit, mediat, qëndrimet dhe perceptimet. Përveç kësaj, për të prodhuar indikatorë kyç për Kosovën si tërësi dhe sipas vendbanimit të respondentëve grumbullimi gjeografik i të dhënave është bërë në disa etapa.

Hulumtimi është realizuar nga Deep Dive, e cila është firmë hulumtuese e tregut dhe konsulencave në Serbi, së bashku me nënkontraktorët. Në Kosovë, mbledhja e të dhënave është realizuar nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA).

Ligji Nr. 04/L-156 mbi Kontrollin e Duhanit, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013, ofron një gamë të gjerë të masave që kanë të bëjnë me parandalimin ose dekurajimin e konsumit të duhanit, megjithatë rezultatet në këtë raport tregojnë se zbatimi i tij mbetet shumë i dobët. Prandaj, qëllimi i këtij raporti është që të paraqesë të gjeturat e hulumtimit mbi konsumimin e duhanit te të rriturit në Kosovë, gjithashtu të ofrojë rekomandime për politika për ta zvogëluar

---

<sup>1</sup> Shënim: shih, për shembull, Gashi. Sanije, et al.: Smoking behaviours in Kosovo: Results of Steps Survey, 2016, në: <https://bit.ly/2VbLEOCm>

<sup>2</sup> Global Adult Tobacco Survey Collaborative Group. Global Adult Tobacco Survey (GATS): Sample Design Manual, Version 2.0. Atlanta, GA: Centers for Disease Control and Prevention, 2010. Marrë 20, 2020, nga <https://bit.ly/2WM6KX8>

<sup>3</sup> International Tobacco Control Policy Evaluation Project. (n.d.). Marrë 5 prill 2020, nga <https://itcproject.org/>

<sup>4</sup> Pricing Policies and Control of Tobacco in Europe. (n.d.). Marrë 5 prill 2020, nga <http://www.tri.ie/ppacte.html>



përdorimin e duhanit. Raporti gjithashtu mbulon një gamë të gjerë të aspekteve lidhur me konsumin e duhanit përfshirë përdorimin dhe prevalencën, ndërprerjen e konsumimit, konsumimin pasiv, ekonominë, mediat, qëndrimet si dhe perceptimet e të rriturve kundrejt politikave të ndryshme mbi kontrollin e duhanit. Qeveria e Kosovës mund t'i shfrytëzojë të gjeturat dhe rekomandimet e këtij studimi në përpjekjet e saja për ta kontrolluar dhe monitoruar përdorimin e duhanit, si dhe për qëllim të draftimit të masave dhe politikave të reja që ndikojnë në zvogëlimin e konsumimit të duhanit.

#### **Të gjeturat kryesore të hulumtimit janë si vijon:**

- 1. Prevalenca dhe sasia e konsumimit të duhanit në Kosovë janë shumë të larta. Afërsisht gjysma e të rriturve burra konsumojnë duhan dhe më shumë se dy të tretat e të gjithë duhanpirësve dhe konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë.** Në Kosovë, 36.4 përqind e të rriturve 18 deri 85 vjeç janë duhanpirës aktualë (që konsumojnë duhan në baza ditore apo më pak). Në mesin e tyre, burrat kanë afërsisht dy herë më shumë gjasë të konsumojnë duhan se sa gratë (48.9 përqind kundrejt 23.8). Për më tepër, 66.6 përqind e duhanpirësve aktualë kanë një intensitet të lartë të pirjes së duhanit prej më shumë se 20 cigare në ditë. Shumica dërmuese e duhanpirësve aktualë (96.9 përqind) konsumojnë cigare të prodhuara, e pasuar nga një përqindje e vogël e atyre që konsumojnë cigare të mbështjella me dorë (3.8 përqind) dhe tuba uji me duhan (0.7 përqind).
- 2. Shumica e duhanpirësve të cilët janë përpjekur ta ndërpresin konsumimin e duhanit (pa sukses) në vitin e fundit, e kanë bërë atë për shkaqe shëndetësore.** Vetëm 16.1 përqind e duhanpirësve aktualë kanë provuar të heqin dorë nga konsumimi i duhanit gjatë 12 muajve të fundit, por më shumë se 50 përqind e tyre nuk kanë qenë në gjendje që të heqin dorë nga duhanpirja për më shumë se një muaj. Ndërsa 13.4 përqind e duhanpirësve gra të cilat kanë bërë përpjekje ta braktisin duhanin gjatë 12 muajve të fundit, kanë arritur të heqin dorë nga konsumimi i duhanit për më shumë se gjashtë muaj krahasuar me 10.9 përqind të duhanpirësve burra. Në përgjithësi, 66.0 përqind e duhanpirësve të cilët kanë bërë përpjekje për ta ndërprerë konsumimin e duhanit gjatë 12 muajve të fundit, e kanë bërë atë për arsye shëndetësore.
- 3. Ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive është i zakonshëm në Kosovë. Më shumë se gjysma e të rriturve i ekspozohet tymit të duhanit në shtëpi, derisa nëntë nga dhjetë në bare dhe klube të natës, si dhe shtatë nga dhjetë në restorante.** Rezultatet tregojnë se 58.0 përqind e duhanpirësve aktualë dhe 43.2 përqind e atyre që nuk konsumojnë duhan janë të ekspozuar ndaj tymit të duhanit në shtëpi, ndërsa 91.2 përqind dhe 69.2 përqind e të rriturve i ekspozohen duhanpirjes pasive në bare dhe klube të natës respektivisht në restorante.
- 4. Çmimet e cigareve në Kosovë janë të ulëta, por pavarësisht kësaj duhanpirësit shpenzojnë më shumë se 17.3 përqind të të ardhurave të tyre mujore në produkte të duhanit.** Katër nga pesë (79.6 përqind) e duhanpirësve aktualë në Kosovë shpenzojnë më pak se 100 euro në muaj në produkte të duhanit, ndërsa çmimi mesatar për pako të cigareve të prodhuara është 1.98 euro. Duhanpirësit aktualë të cigareve të prodhuara shpenzojnë 17.1 përqind të të ardhurave të tyre mujore në cigare.
- 5. Megjithëse çmimet e cigareve janë të ulëta, cigaret perceptohen gjerësisht si të shtrenjta.** Pavarësisht nga të ardhurat apo statusi i duhanpirjes, afërsisht 70 përqind

e të rriturve e perceptojnë çmimin e cigareve si “të shtrenjtë” apo “shumë të shtrenjtë”. Ndërsa gratë e perceptojnë atë si “të shtrenjtë” krahasuar me burrat.

6. **Rritja e çmimit të cigareve (31.1 përqind) dhe të bërit ilegal pirjen e duhanit apo shitjen e produkteve të duhanit (33.9 përqind) perceptohen si dy politika shumë të suksesshme të qeverisë për ta kontrolluar dhe kufizuar përdorimin e duhanit.** Megjithatë, shumica e duhanpirësve aktualë e kundërshtojnë ngritjen e çmimeve. Tre nga katër (67.2 përqind) dhe katër nga pesë (79.5 përqind) e duhanpirësve aktualë janë fuqishëm kundër rritjes së çmimit prej pesë dhe 20 përqind.

### **Rekomandimet**

Disa masa të Qeverisë së Kosovës janë të nevojshme për ta reduktuar konsumimin e produkteve të duhanit. Rekomandimet në vijim janë ofruar bazuar në të gjeturat e këtij studimi:

1. **Të rritet ndjeshëm akciza për produktet e duhanit për ta zvogëluar kështu konsumimin e cigareve.**<sup>5</sup>
2. **Të fuqizohet zbatimi i ligjeve kundër duhanit.**
3. **Të organizohen kampanja mbarëkombëtare për ta rritur vetëdijen publike, veçanërisht në shkollat e mesme dhe universitete, por edhe te punëtorët shëndetësorë dhe profesionistët e mediave lidhur me rreziqet shëndetësore nga konsumimi i duhanit dhe duhanpirjes pasive si dhe përfitimet nga ndërprerja e duhanit.**

---

<sup>5</sup> Studimi i realizuar në vitin 2019 gjen se, një rritje në çmimin mesatar të tregut për pako të cigareve për 25 përqind, e cila do të rezultonte nga një 47.8 përqind e rritjes së akcizës, do të zvogëlonte konsumimin për 11.1 përqind dhe do të rriste të ardhurat e qeverisë për rreth 26 përqind. Për më shumë detaje shiko: Pula, E., & Prekazi, B. (2019). *Impact on tobacco excise increases on cigarette consumption and government revenues in Southeastern European countries. Chapter 5 Kosovo*. f-35. Marrë nga <http://bit.ly/38OKfED>

## LISTA E SHKURTESAVE<sup>6</sup>

CAPI	Computer-Assisted Personal Interviewing
D+	Democracy Plus
FCTC	Framework Convention on Tobacco Control
GATS	Global Adult Tobacco Survey
IES	Institute of Economic Sciences
ITCS	International Tobacco Control Survey
UIC	University of Illinois at Chicago
HBS	Household Budget Survey
HTP	Heated Tobacco Products
IDRA	Institute for Development Research and Alternatives
PPACTE	Pricing Policies and Control of Tobacco in Europe
SRSWOR	Simple Random Sampling Without Replacement
PSU	Sampling Point Unit
SHS	Secondhand smoke
WHO	World Health Organization

---

<sup>6</sup> Lista e shkurtesave nuk është përkthyer në gjuhën shqipe për arsyë se disa prej definicioneve dhe shtimeve të listuara nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe. Në tekst këto shkurtesa përodren në formën orgjinale të paraprirë nga shpejgime në gjuhën shqipe, të përkthyer nga autorët.

## FJALOR

**Duhanpirës aktual:** Një i rritur i cili ka konsumuar së paku 100 cigare (duke përfshirë ato të prodhuara dhe të mbështjella me dorë) në jetën e tij dhe i cili aktualisht konsumon duhan.

**Duhanpirës i përditshëm:** Një i rritur i cili ka konsumuar së paku 100 cigare (duke përfshirë ato të prodhuara dhe të mbështjella me dorë) në jetën e tij dhe i cili aktualisht konsumon duhan çdo ditë.

**Duhanpirës jo i përditshëm (duhanpirës rastësor):** Një i rritur i cili ka konsumuar së paku 100 cigare në jetën e tij, që ende konsumon, por nuk përdor produkte të duhanit çdo ditë.

**Ish-duhanpirës:** Një i rritur i cili ka konsumuar së paku 100 cigare në jetën e tij, por i cili e ka ndërprerë konsumimin në kohën e intervistimit.

**Përherë duhanpirës:** Një i rritur i cili ka konsumuar së paku 100 cigare (duke përfshirë ato të prodhuara dhe të mbështjella me dorë) gjatë jetës së tij.

**Gjithmonë duhanpirës i përditshëm:** Duhanpirës aktual apo ish-duhanpirës i cili ka përdorur apo aktualisht përdor produkte të duhanit në baza ditore.

**Asnjëherë duhanpirës:** Një i rritur i cili kurrë nuk ka provuar konsumimin e duhanit, apo i cili ka konsumuar më pak se 100 cigare në jetën e tij/saj.

**Jo-duhanpirës:** Një i rritur i cili nuk ka konsumuar duhan apo nuk ka provuar më shumë se disa herë, i cili ka konsumuar më pak se 100 cigare në jetën e tij/saj, apo i cili ka konsumuar duhan, por e ka ndërprerë pastaj.

**Produkt i duhanit:** Një produkt i cili është bërë tërësisht apo pjesërisht nga gjethet e duhanit si lëndë e parë, i cili është i prodhuar për t'u përdorur për tymosje, përtypje apo nuhatje.

**Produktet e duhanit për tymosje:** Produktet e duhanit për tymosje të cilat përfshijnë cigaret e prodhuara, cigaret e mbështjella me dorë, purot, cigarillot, çibukët e duhanit, dhe nargjila/shisha (produktet e tymosjes së duhanit me tub uji).

**Cigaret:** Një cilindër i hollë i duhanit të bluar apo copëtuar i cili është i mbështjellë në letër, që ndezët dhe tymoset. Ky term përfshinë cigaret e prodhuara dhe cigaret e mbështjella me dorë.

**Duhani pa tym:** Përfshinë produktet e duhanit të cilat nuhaten përmes hundës, mbahen në gojë apo përtypen.

**Cigaret elektronike:** Një pajisje e cila ka formën e cigares, puros, apo lapsit dhe e cila nuk përmban duhan. Ajo shfrytëzon një bateri dhe përmban një solucion nikotine, aromatizues dhe materie tjera kimike, disa nga të cilat mund të jenë të dëmshme. Ato prodhojnë një avull nga lëngu.

**Produktet e duhanit me ngrohje:** Një produkt duhani i cili prodhon aerosolë që përmban nikotinë dhe materie tjera kimike, të cilat thithen nga përdoruesit përmes gojës.

**Përpjekja për ta ndërprerë duhanin:** Një përpjekje për ta ndërprerë konsumimin e duhanit për së paku një ditë me qëllimin për ta ndërprerë plotësisht.

**Raporti i ndërprerjes:** Raporti i ish-duhanpirësve në mesin e gjithnjë duhanpirësve.

**Duhan pirja pasive:** Tymi i cili vjen nga djegia e një produkti të duhanit dhe tymi i cili nxirret nga duhanpirësit. Thithja e këtij tymi quhet duhanpirje jovullnetare apo pasive. Gjithashtu quhet tym duhani ambiental.

**Ndërprerja e duhanpirjes:** Procesi i ndërprerjes së konsumit të duhanit.

**Mosha e fillimit të konsumimit të përditshëm të duhanit:** Mosha kur një individ fillon përdorimin e produkteve të duhanit në baza ditore.

**Intensiteti i konsumimit të duhanit:** Numri i cigareve të konsumuara në ditë nga duhanpirësit ditorë.

**Niveli i edukimit fillor:** Kryerja e nëntë klasave të para në shkollë.

**Niveli i edukimit të mesëm:** Kryerja e shkollës së mesme (tri vite pas nëntë klasave të para), ku përfshin edukimin profesional (dy apo tri vite të shkollimit të mesëm).

**Niveli i edukimit të lartë:** Një diplomë e fituar nga një “shkollë e lartë”, “kolegj” apo universitet i akredituar (përfshirë gradat akademike themelor, master apo doktoraturë).

## 1. HYRJE

Kosova është një vend relativisht i vogël, me një territor prej 10,887 kilometra katrorë, e pozicionuar në Evropën Juglindore. Sipas raportit të Agjencisë së Statistikave të vitit 2018, Kosova ka një popullatë prej 1.8 milion banorë.<sup>7</sup> Moshë mesatare në Kosovë është 26 vjet, dhe afërsisht 38 përqind e popullatës është më e re se 20 vjet. Kosova ka një GDP për kokë banori prej 4,321 dollar amerikan, ndërsa në vitin 2019 e njëjta kishte pësuar rritje, duke u listuar kështu në ranglistën e Bankës Botërore si vend me të hyra të mesme të larta.<sup>8</sup>

Bazuar në një numër të raporteve mbi konsumimin e duhanit në Kosovë,<sup>9</sup> të gjeturat tregojnë se konsumimi i produkteve të duhanit si dhe prevalenca e duhanpirjes në Kosovë janë relativisht të larta. Raporti i vitit 2018, “Ekonomia e Duhanit dhe Taksat mbi Duhanin”, bazuar në të dhënat e Doganave të Kosovës, tregon se vlera dhe volumi i importeve të duhanit në Kosovë janë gjithashtu mjaftë të larta. Nga 2006 deri në 2017, vlera e produkteve të importuara të duhanit u rrit nga 30 milionë euro në 70 milionë euro,<sup>10</sup> përderisa sasia e duhanit të importuar në periudhën e njëjtë kohore mbeti stabile në afërsisht tre tonë në vit.<sup>11</sup>

Raporti i vitit 2019, “Ndikimi i Rritjes së Akcizës së Duhanit në Konsumimin e Cigareve dhe të Hyrat e Qeverive në Vendet e Evropës Juglindore”, bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (HBS), vlerëson që më shumë se 40 përqind e ekonomive familjare në Kosovë konsumojnë produkte të duhanit, dhe secila prej tyre konsumon më shumë se 40 pako të cigareve në muaj.<sup>12</sup>

Kosova ka adoptuar disa ligje për të kontrolluar dhe zvogëluar konsumimin e duhanit duke përfshirë Ligjin për Akcizën në Produktet e Duhanit<sup>13</sup> aprovuar në vitin 2011; Ligjin mbi Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit<sup>14</sup>, i cili gjithashtu ka hyrë në fuqi në vitin 2011, si dhe ligji i fundit dhe më i rëndësishmi lidhur me konsumimin e duhanit, Ligji për Kontrollin e Duhanit,<sup>15</sup> i cili ka hyri në fuqi në vitin 2013. Ky i fundit është në harmoni me nenin 5 të Konventës Kornizë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) për Kontrollin e Duhanit (FCTC),<sup>16</sup> e cila rekomandon strategji të shumta për të kontrolluar konsumin e duhanit. Qëllimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit është që ta mbrojë popullsinë nga sëmundjet që shkaktohen nga konsumimi i duhanit, prandaj ai ndalon një gamë të gjerë të aktiviteteve që kanë të bëjnë me pengimin apo dekurajimin e të rriturve për të konsumuar

---

<sup>7</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2019). *Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2018*. Marrë nga <https://bit.ly/3agghkd2>

<sup>8</sup> Banka Botërore. (2019). *Banka Botërore në Kosovë*. Marrë nga <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

<sup>9</sup> Shiko: 1) Palushi, L., Prekazi, B., Statovci, J., & Bylykbashi Deliu, N. (2018). *National study - KOSOVO economics of tobacco and tobacco taxation*. Marrë nga <https://bit.ly/2wxihyS> dhe 2) Pula, E., & Prekazi, B. (2019). *Impact of tobacco excise increases on cigarette consumption and government revenues in Southeastern European countries. Chapter 5 Kosovo*. Marrë nga <http://bit.ly/38OKfED>

<sup>10</sup> Palushi, L., Prekazi, B., Statovci, J., & Bylykbashi Deliu, N. (2018). *Studim kombëtar - Ekonomia e KOSOVES mbi duhanin dhe taksat mbi duhanin*. Marrë nga <https://bit.ly/2wxihyS>

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Palushi, L., Prekazi, B., Statovci, J., & Bylykbashi Deliu, N. (2018). *National study - KOSOVO economics of tobacco and tobacco taxation*. Marrë nga <http://bit.ly/38OKfED>

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare LIGJI NR. 04/L-021 PER AKCIZEN NE PRODUKTET E DUHANIT. Marrë nga <http://bit.ly/33dCioN>

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare LIGJI NR. 04/L-041 PER PRODHIMIN, GRUMBULLIMIN, PERPUNIMIN DHE TREGTINE E DUHANIT. Marrë nga <http://bit.ly/339QPSi>

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare LIGJI Nr. 04/L-156 PER KONTROLLIN E DUHANIT. Marrë nga <http://bit.ly/33emngg>

<sup>16</sup> WHO Framework Convention on Tobacco Control <http://bit.ly/Worldhofc>

duhan. Ky ligj, ndalon promovimin, reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit, po ashtu ndalon konsumimin e duhanit në ambiente të brendshme siç janë shtëpitë, vendet e punës dhe hapësirat publike. Për më tepër, ai mbështet masat parandaluese duke përfshirë kampanjat vetëdijësuese mbi efektet e dëmshme të konsumimit të duhanit. Megjithatë, të gjeturat e këtij raporti tregojnë se ka një zbatim të dobët të ligjit, veçanërisht sa i përket konsumimit të duhanit në ambientet e brendshme në hapsirat publike, pasi 69.2 përqind e të rriturve i ekspozohen tymit të duhanit në restorante dhe 91.2 përqind e të rriturve i ekspozohen në bare dhe klube të natës.

Ky raport është organizuar si në vijim. Kapitulli 2 përshkruan metodologjinë, ndërsa kapitujt 3 deri në 8 paraqesin të gjeturat e hulumtimit mbi aspekte të ndryshme të përdorimit të duhanit. Kapitulli 3 paraqet të gjeturat e hulumtimit mbi përdorimin e të gjitha llojeve të produkteve të duhanit nga të rriturit, prevalencën dhe intensitetin e konsumimit të produkteve të duhanit. Kapitulli 4 mbulon të gjeturat për përpjekjet e duhanpirësve për ta ndërprerë konsumimin e duhanit. Ky kapitull tregon kohëzgjatjen më të madhe të abstenimit nga duhani, arsyet dhe metodat e përdorura në përpjekje për ta ndërprerë konsumimin e duhanit, intensitetin e duhanpirjes në të kaluarën dhe të tashmen, nëse duhanpirësit aktualë e kanë zvogëluar intensitetin e tyre të pirjes së duhanit, si dhe arsyet për zvogëlim. Kapitulli 5 paraqet të gjeturat për ekspozimin ndaj tymit të duhanit apo duhanpirjes pasive. Ai mbulon çështje siç janë ekspozimi ndaj tymit të duhanit në vende të ndryshme dhe përvojat e duhanpirësve karshi reagimeve të të tjerëve. Kapitulli 6 mbulon të gjeturat mbi aspektet ekonomike të përdorimit të duhanit. Ai paraqet çmimet që përdoruesit paguajnë për lloje të ndryshme të duhanit, përqindjen e buxhetit mujor të shpenzuar në duhan, brendet më të konsumuara të duhanit, vendet ku blerësit blejnë produkte të duhanit dhe sjelljet/përceptimet e duhanpirësve në Kosovë. Kapitulli 7 paraqet të gjeturat mbi promovimin e duhanit në media dhe mjetet tjera, prezencën e vërejtjet dhe porositë për shëndetin si dhe banderolën e taksave në pakot e cigareve. Gjithashtu, ai paraqet të gjeturat e hulumtimit mbi qëndrimet dhe perceptimet kundrejt politikave anti-duhan, dhe ngritjen eventuale të çmimeve në shkallë të ndryshme. Në fund, Kapitulli 8 paraqet konkluzionet dhe ofron rekomandime për politikën për Qeverinë e Kosovës.

## 2. METODOLOGJIA

Bazuar në protokollin global të standardeve për monitorim sistematik të përdorimit të duhanit nga të rriturit dhe në indikatorët kyç të duhanit, D+ si pjesë e projektit “Përshpejtimi i Progresit në taksat mbi Duhanin në Vendet me të Ardhura të Ulëta dhe të Mesme”, ka realizuar një hulumtim mbi përdorimin e duhanit në mesin e të rriturve në Kosovë, si pjesë e Hulumtimit Rajonal mbi Konsumimin e Duhanit në vendet e Evropës Juglindore (STC-SEE). Hulumtimi është realizuar në gjashtë vende të Evropës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, dhe Serbinë. Hulumtimi është koordinuar nga Instituti i Shkencave Ekonomike (IES) në Beograd dhe është financuar nga Universiteti i Illinois në Çikago (UIC) Instituti për Kërkime dhe Politika Shëndetësore.

Pyetëtori i STC-SEE është bazuar në pyetëtorët e tri hulumtimeve globale ekzistuese, duke përfshirë Hulumtimin Global të Duhanit të të Rriturit (GATS),<sup>17</sup> Hulumtimin Ndërkombëtar të Kontrollit të Duhanit (ITC)<sup>18</sup> dhe Hulumtimin e Politikave të Çmimeve dhe Kontrollit të Duhanit në Evropë (PPACTE).<sup>19</sup> GATS është një hulumtim i cili përfshinë ekonomitë familjare, dhe mbledh të dhëna për personat mbi moshën 15 vjeç, të cilat përdoren nga qeveritë për të ofruar rekomandime për dizajnimin e politikave që adresojnë masat të cilat i përmban Konventa Kornizë mbi Kontrollin e Duhanit (FCTC) e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Hulumtimi i ITC administrohet përmes ueb-it dhe mbledh të dhëna mbi sjelljet dhe qëndrimet lidhur me përdorimin e duhanit dhe nikotinës nga të rriturit mbi 20 vjeç. Hulumtimi i ITC realizohet në më shumë se 29 vende, dhe ka për qëllim të vlerësojë zbatimin e masave të FCTC. Ndërsa, PPACTE është një hulumtim mbi efikasitetin e politikave të çmimeve karshi prevalencës së duhanit, ndërprerjes dhe faktorëve të tjerë. Ky hulumtim realizohet në 18 vende evropiane dhe përfshin personat mbi 15 vjeç.

Mostra e hulumtimit në Kosovë përbëhet nga 1,000 të rritur të moshës 18 deri 85 vjeç, e dizajnuar të përfaqësoj tërë popullsinë e Kosovës bazuar në regjistrimin e fundit nacional (2011). Qëllimi i hulumtimit është mbledhja e informacioneve nga respondentët mbi karakteristikat e tyre biografike, përdorimin e duhanit (të gjitha llojet), ndërprerjen e konsumimit të duhanit, ekspozimin ndaj duhanpirjes pasive, ekonominë e duhanit, mediat, si dhe qëndrimet dhe perceptimet. Përveç kësaj, për të prodhuar indikatorë kyç për Kosovën si tërësi dhe sipas vendbanimit të respondentëve grumbullimi gjeografik i të dhënave është bërë në disa etapa.

Hulumtimit është realizuar nga Deep Dive, e cila është firmë hulumtuese e tregut dhe konsulencave në Serbi, së bashku me nënkontraktorët. Në Kosovë, mbledhja e të dhënave është realizuar nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA).

### 2.1. POPULLATA E STUDIUAR

Popullata e targetuar nga studimi përfshinë të gjithë burrat dhe gratë 18 deri 85 vjeç, dhe mbulon tërë territorin e Kosovës. Për arsye logjistike, hulumtimi nuk është realizuar në ambiente banimi të institucionalizuara apo banesa kolektive, siç janë institucionet ushtarake,

---

<sup>17</sup> Global Adult Tobacco Survey Collaborative Group. Global Adult Tobacco Survey (GATS): Sample design manual, version 2.0. Atlanta, GA: Centers for Disease Control and Prevention, 2010. Marrë nga <https://bit.ly/2WM6KX8>

<sup>18</sup> International Tobacco Control Policy Evaluation Project. (n.d.). Marrë nga <https://itcproject.org/>

<sup>19</sup> Pricing Policies and Control of Tobacco in Europe. (n.d.). Marrë 2020, nga <http://www.tri.ie/ppacte.html>



burgje, manastire, hotele, konvikte, spitale, dhe shtëpi pleqsh. Të anketuarit e kualifikuar e kanë pasur të drejtën për t'u tërhequr nga intervista në çdo kohë, si dhe të refuzonin të përgjigjeshin në çfarëdo pyetje pa i ofruar arsye shtesë intervistuesit.

## 2.2. MODELIMI I MOSTRËS

Hulumtimi është dizajnuar si hulumtim nacional, ballë për ballë, me një mostër prej 1,000 të rriturish nga moshë 18 deri në 85 vjeç. Hulumtimi përdor një mostër të probabilitetit në tri faza. Në fazën e parë, njësitë primare të mostrës (PSU) janë përzgjedhur rastësisht nga probabiliteti proporcional duke përfshirë shtatë rajonet (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, dhe Prizren). Në fazën e dytë, dhjetë njësi banimi në secilën PSU janë përzgjedhur rastësisht përmes metodës së përzgjedhjes së rastësishme të adresës duke respektuar intervalin e mostrës. Në fazën e tretë, anëtarët e familjes janë përzgjedhur rastësisht duke përdorur teknikën e ditëlindjes vijuese. Nuk ka pasur zëvendësim për respondentët e kualifikuar.

Alokimi i mostrës sipas kategorive është proporcional me madhësinë e mostrës për nënkategori të caktuara (numri i personave të moshës 18 deri 85 vjeç). Kategorizimi i mëtutjeshëm i të dhënave është bërë sipas gjinisë, moshës, llojit të banimit, rajonit gjeo-ekonomik dhe nivelit të edukimit. Intervali i besimit prej 95 përqind në madhësinë e mostrës prej 1,000 është CI 3.1 përqind (46.9 përqind, 53.1 përqind).

## 2.3. PYETËSORI I HULUMTIMIT

Pyetëtori i hulumtimit ka mbledhur informacione rreth një numri të madh indikatorësh të cilët ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e prevalencës së përdorimit të duhanit dhe në ofrimin e të dhënave për politikbërësit për dizajnimin e politikave të reja apo fuqizimin e atyre ekzistuese lidhur me kontrollin e duhanit në nivel kombëtar. Pyetëtori është përpiluar në anglisht dhe përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe nga punëtorët e terrenit.

Pyetëtori ka përfshirë pyetje për informacione që kanë të bëjnë me shtatë fushat vijuese:

- a) *Karakteristikat biografike*: Pyetje mbi moshën, gjininë, vendbanimin, nivelin e edukimit, statusin e punësimit, të hyrat mujore, statusin shëndetësor, numrin e fëmijëve dhe statusin martesor.
- b) *Përdorimi i duhanit*: Pyetje që mbulojnë trendin dhe frekuencën e përdorimit (konsumimin ditor, më pak se në baza ditore, ish-duhanpirës, joduhanpirës), konsumimin e llojeve të ndryshme të duhanit, intensitetin e duhanpirjes dhe moshën e fillimit të konsumimit të duhanit në baza ditore.
- c) *Ndërprerja e konsumimit të duhanit*: Pyetje mbi periudhën më të gjatë të abstenimit nga konsumimi i duhanit, arsyet e tentativës për ta ndërprerë duhanin, metodat e përdorura për ta ndërprerë duhanin, intensitetin e konsumimit të duhanit në krahasim me të kaluarën dhe arsyet e konsumimit më të vogël.
- d) *Duhanpirja pasive*: Pyetje për duhanpirës edhe joduhanpirës mbi ekspozimin ndaj tymit të duhanit në shtëpi, si dhe ekspozimit si duhanpirës pasiv gjatë 30 ditëve të fundit në vende të ndryshme publike duke përfshirë ndërtesa qeveritare, objekte shëndetësore, restorante apo kafe, bare apo klube të natës, universitete dhe shkolla. Pyetjet gjithashtu identifikojnë numrin e fëmijëve në shtëpi dhe ekspozimin e tyre ndaj

tymit të duhanit. Duhanpirësit aktualë janë pyetur nëse tymi i tyre i duhanit i shqetëson të tjerët.

- e) *Ekonomia*: Pyetje mbi buxhetin mesatarë të shpenzuar në cigare të prodhuara dhe cigare të mbështjella me dorë, përqindja totale e të ardhurave të shpenzuara në duhan, brendi i fundit i blerë, shpenzimet mujore për produkte të ndryshme të duhanit, numri mesatar i cigareve të prodhuara dhe të mbështjella me dorë të konsumuara në ditë.
- f) *Qëndrimet dhe perceptimet*: Pyetje mbi reagimet ndaj rritjes së çmimit siq janë: nuk ka ndonjë ndryshim, ndërprerje e përkohshme e duhanit, konsumim më i ulët i duhanit, konsumimi i brendeve më të lira, kalimi në cigare të mbështjella me dorë, kalimi në cigare jolegale.
- g) *Media*: Pyetje rreth njohurive mbi ngjarje të sponsorizuara nga industria e duhanit, lidhur me promovimin e duhanit në gjashtë muajt e fundit (mostra falas të cigareve, oferta me çmime speciale për çfarëdo produkti të duhanit, dhurata apo zbritje speciale kur blen cigare, veshje apo gjera tjera me një emër brendi të cigareve apo logo, ngjarje të veçanta ku duhanpirësit ftohen për të marrë pjesë apo dërgojnë letra elektronike me mesazhe promocionale), vërejtjet dhe porositë për shëndetin si dhe banderolat e taksave në pakot e cigareve.

## 2.4 AGJENCIONI IMPLEMENTUES

Deep Dive, që është një firmë për hulumtime të tregut dhe konsulenca me bazë në Beograd, Serbi, ishte përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave për STC-SEE në të gjashtë vendet. Menaxheri i projektit i Deep Dive ofroi udhëzime të përgjithshme për zbatimin e hulumtimit në secilin vend dhe ishte në komunikim të vazhdueshëm me drejtorët në secilin prej gjashtë vendeve respektive për t'u siguruar kështu që të gjitha procedurat jenë përcjellur siç duhet. Hulumtimi në Kosovë është realizua nga IDRA, bazuar në të njëjtat rregulla dhe rregullore sikur agjencia Deep Dive, siç është përcaktuar në marrëveshje ndërmjet agjencisë dhe secilit nënkontraktor në rajon.

## 2.5. REKRUTIMI

Për të realizuar hulumtimin në Kosovë, IDRA ka punësuar në total 34 punëtorë terreni, të shpërndarë në shtatë zona dhe pesë regjione gjeo-ekonomike (Jug, Lindje, Qendër, Perëndim dhe Veri). Pra, kanë qenë 25 intervistues të terrenit për zonat të banuara me shqiptarë, gjithashtu dy intervistuesë tjerë për pilotimin e pyetësorëve. Në zonat e Kosovës me banorë serb, agjencia ka punësuar intervistuesë serbë për t'i realizuar këto intervista.

## 2.6. PARATESTI/PILOT TESTI

Pilot studimi (paratesti) është realizuar në qershor të vitit 2019. Hulumtimi pilot ka ofruar qartësi në pyetje, rrjedhë logjike apo sekuencë të pyetjeve, përshtatshmëri dhe përgjigje të duhura në kategoritë e përdorura, si dhe qartësi dhe korrektësi të formulimit edhe në gjuhët nacionale. Pilotimi gjithashtu ka pasur për qëllim të përcaktojë nëse qëndrimet e respondentëve, interesat dhe motivimi për t'u përgjigjur në pyetje do të ishte konstant dhe të vendoste kohën mesatare që merr intervista me qëllim që të vendoset pastaj një kuotë e arsyeshme ditore. Një tjetër objektiv i rëndësishëm i pilotimit ishte testimi i shkrimit

(pyetësoi i programuar) pasi që pyetësoi ishte administruar duke përdorur metodën e mbledhjes së të dhënave CAPI. Pilot-hulumtimi ishte realizuar në zona rurale dhe urbane, me një total prej 10 respondentëve. Pilot intervistat ishin shpërndarë në mënyrë adekuate sipas gjinisë, vendbanimit urban/rural, statusit duhanpirës, dhe grupmoshës.

## **2.7. TRAJNIMI**

Trajnimi për të gjithë personelin e angazhuar për punën në terren për STC-SEE në Kosovë ishte realizuar në mes të 2 dhe 13 shtatorit të vitit 2019. Menaxherët e këtij projekti shërbyen si trajner, ku pjesëmarrës në trajnime kanë qenë mbikëqyrësit rajonalë, mbikëqyrësit e punës në terren dhe intervistuesit në terren. Secili sesion trajnues ka mbuluar konceptet e hulumtimit, definicionet, si dhe administrimin e pyetësorëve duke përdorur kompjuterët në formë tableti.

## **2.8. PUNA NË TERREN**

Pesë (katër shqiptarë dhe një serb) menaxherë të punës në terren u caktuan për ta mbikëqyruar zbatimin e hulumtimit në zonat e tyre të caktuara dhe të ofronin asistencë teknike mbi konceptet e hulumtimit, njësitë e pyetësorit dhe procedurat e operimit në terren. Ata gjithashtu ofruan mbështetje teknike mbi përdorimin e kompjuterëve tablet, derisa ekipi i TI i Deep Dive adresoi çështje më të komplikuar. Mbikëqyrësit e punës në terren realizuan kontrole rutinore dhe mbikëqyrësit e cilësisë së kontrollit nga IDRA realizuan intervista të shkurtra verifikuese. Puna në terren u realizua nga 17 shtator deri më 7 tetor 2019.

## **2.9. GRUMBULLIMI DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE**

Si në pesë vendet tjera, STC-SEE në Kosovë përdori një pyetësor elektronik përmes kompjuterëve tablet. Instalimi pyetësorit, software-i përpunues, menaxhimi dhe integrimi i të dhënave është menaxhuar nga Deep Dive, ku stafi teknik i Deep Dive ka shërbyer edhe si menaxhues të të dhënave. Intervistuesit në terren ngarkuan të dhënat në serverët e Deep Dive në baza ditore. Për zbulimin e hershëm dhe zgjidhjen e problemeve në dosjet e të dhënave, menaxhuesit e të dhënave kanë rishikuar dhe kontrolluar të dhënat e pranuar. Të njëjtit kanë ofruar raport të statusit javor duke treguar numrin e rasteve të kompletuara dhe të pakompletuara për intervistuesin. Pas kompletimit të databazës, menaxhuesit e të dhënave të Deep Dive i kanë shëndrruar të dhënat në format SPSS për vlerësim fillestar të cilësisë së të dhënave.

## **2.10. ANALIZA STATISTIKORE**

Analizimi i të dhënave komplekse të hulumtimit është realizuar për të marrë vlerësime dhe për ta matur shkallën e besueshmërisë prej 95 përqind. Koeficienti është shfrytëzuar për të nxjerrur vlerësime të popullatës dhe besueshmërinë e tyre. Të gjithë koeficientet kompjuterik dhe intervalet e tyre të besimit janë realizuar duke përdorur modulën e mostrës komplekse të SPSS 26.

## **2.11. KOEFICIENTI**

Rregullimi i të dhënave është bërë për t'i korrigjuar koeficientet në shpërndarjen e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011. Variablat e përdorura për kalibrim kanë qenë rajoni gjeo-ekonomik, lloji i banimit (urban kundrejt rural), grupmosha, gjinia, dhe niveli i edukimit (Tabelat 2.1–2.7 në Shtojcë).

## **2.12 KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS DHE POPULLATËS**

1,000 intervistat e kompletuara në Kosovë përfshijnë popullatën nga 18 deri 85 vjeç. Kornizat e mostrave janë të bazuara në regjistrimin e fundit të popullsisë, i realizuar në vitin 2011.

### 3. PËRDORIMI I DUHANIT



#### Mesazhet kyçe


- 1. Prevalenca e konsumimit të cigareve të prodhuara dhe cigareve të mbështjella me dorë në mesin e të rriturve në Kosovë është shumë e lartë, 36.4 përqind: 48.9 përqind në mesin e burrave dhe 23.8 përqind në mesin e grave. Intensiteti i duhanpirjes është gjithashtu i lartë, pasi që afërsisht 70 përqind e duhanpirësve të përditshëm në Kosovë konsumojnë një mesatare prej më shumë se 20 cigare në ditë.*
- 2. Afërsisht 40 përqind e duhanpirësve të përditshëm filluan konsumimin e duhanit para moshës 18 vjeçare, përderisa 45.0 përqind filluan tymosjen ndërmjet moshës 18 dhe 24 vjeçare.*
- 3. Të rriturit me të ardhura të larta (67.5 përqind), ata me nivel sekondar të edukimit (37.3 përqind), dhe të rriturit që jetojnë në zonat urbane (39.9 përqind) konsumojnë duhan relativisht më shumë se sa të rriturit tjerë.*

Ky kapitull raporton të gjeturat e hulumtimit lidhur me prevalencën e përdorimit të produkteve të ndryshme të duhanit në Kosovë. Është i ndarë në tri seksione, më saktësisht në prezantimin e të gjeturave mbi përdorimin e produkteve të duhanit, numrin e cigareve të përdorura në një ditë dhe moshën kur duhanpirësit kanë filluar konsumimin e duhanit në baza ditore. Hulumtimi ka mbledhur të dhëna mbi konsumimin e llojeve të ndryshme të produkteve të duhanit siç janë duhani me tym, duhani pa tym, cigaret elektronike (e-cigaret), dhe produktet e duhanit me ngrohje. Produktet e duhanit me tym përfshijnë cigaret e prodhuara, cigaret e mbështjella me dorë, çibukët e duhanit, cigaret apo cigarillot, si dhe duhanin me tuba uji.

Pasi që duhanpirësit aktualë konsumojnë vetëm duhan me tym siç janë cigaret e prodhuara (96.9 përqind), cigaret e mbështjella me dorë (3.8 përqind) dhe duhanin me tuba uji (0.7 përqind)<sup>20</sup> (Tabela 3.2 në shtojcë), ky kapitull fokusohet kryesisht në duhanin me tym, veçanërisht në cigaret e prodhuara.

Në Kosovë, 36.4 përqind e të rriturve (nga moshë 18 deri 85) janë duhanpirës aktualë. Figura 3.1 tregon se burrat ka gjasë të konsumojnë dy herë më shumë duhan sesa gratë (48.9 përqind kundrejt 23.8 përqind).

<sup>20</sup> Pasi që disa duhanpirës konsumojnë më shumë se dy lloje të produkteve të duhanit, shuma totale e përqindjes është më e madhe se 100.

**Figura 3.1** Prevalenca e konsumimit ditor të duhanit në mesin e burrave është më shumë se dy herë më e lartë se sa te gratë (N=998<sup>21</sup>)

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Në përgjithësi, 34.4 përqind e të rriturve në Kosovë janë duhanpirës të përditshëm. Megjithatë, prevalenca e duhanpirësve të përditshëm është shumë më e lartë në mesin e burrave (47.0 përqind) sesa në mesin e grave (21.7) (Figura 3.1). Të rriturit në grupmoshën prej 45-54 kanë prevalencën më të lartë të duhanpirjes, me 44.9 përqind, ndjekur nga grupmosha 35–44 me 35.5 përqind. Për më tepër, prevalenca e duhanpirësve të përditshëm është më e larta te të rriturit me nivel të mesëm arsimimi (37.3 përqind), pasuar nga ata me arsimim fillor apo me nivel të ulët arsimimi (32.8 përqind) dhe nga ata me nivel më të lartë të arsimimit, me 29.0 përqind (Tabela 3.1 në shtojcë).

Nga duhanpirësit e përditshëm, të rriturit që jetojnë në zona urbane kanë prevalencë relativisht më të lartë (39.9 përqind) sesa ata që jetojnë në zona rurale (30.9 përqind). Ekonomitë familjare me të ardhura më të larta mujore kanë një prevalencë më të lartë të duhanpirjes, pasi që 67.5 përqind e të rriturve me të hyra mujore nga 1,201 deri në 1,600 euro konsumojnë duhan në baza ditore, përderisa vetëm 30.8 përqind e atyre të cilët fitojnë më pak se 400 euro në muaj janë duhanpirës të përditshëm (Tabela 3.1 në shtojcë).

Vetëm 2.0 përqind e të rriturve në Kosovë janë duhanpirës rastësor — 2.1 përqind në mesin e grave (përqindja prej 8.8 paraqet numrin total të duhanpirësve aktuale gra) dhe 1.9 përqind në mesin e burrave (që paraqet 3.9 përqind të të gjithë duhanpirësve aktualë burra).

Në përgjithësi 41.6 përqind e të rriturve në Kosovë kurrë nuk kanë konsumuar duhan, dukshëm më shumë gratë (60.6 përqind) sesa burrat (22.9 përqind) (Tabela 3.1 në shtojcë).

### 3.1. PËRDORIMI I LLOJEVE TË NDRYSHME TË DUHANIT TYMOSËS

Tabela 3.2 në shtojcë paraqet përqindjen e duhanpirësve aktualë, sipas llojit të produkteve të duhanit tymosës. Cigaret e prodhuara dominojnë në mesin e produkteve të duhanit tymosës me 96.9 përqind të duhanpirësve, ndërsa 3.8 përqind konsumojnë cigare të mbështjella me dorë dhe vetëm 0.7 përqind konsumojnë duhan në tuba uji (nargjilë/shisha). Konsumimi i


<sup>21</sup> Mostra e hulumtimit ka përfshirë 1,000 respondentë, dy observime përjashtuar nga analiza.

llojeve tjera të produkteve të duhanit nga të rriturit është minimal, dhe disa nga të intervistuarit theksuan që ka pasur raste kur vetëm i kanë provuar ato. Shiko më shumë detaje në Tabelën 3.2 në shtojcë.

### 3.2. CIGARET E KONSUMUARA NË BAZA DITORE

Figura 3.2 tregon se në përgjithësi, 69.5 përqind e duhanpirësve aktualë konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë. Intensiteti i duhanpirjes te burrat është relativisht më i lartë sesa te gratë, kjo pasi 80.1 përqind e duhanpirësve burra konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë krahasuar me 47.0 përqind të duhanpirësve gra.

**Figura 3.2.** Intensiteti i pirjes së duhanit është i lartë, pasi që shumica e duhanpirësve aktualë, veçanërisht burrat, konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë (N=337)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Duhanpirësit aktualë nën moshën 75 vjeçare konsumojnë duhan relativisht më shumë (më shumë se 20 cigare në ditë) në krahasim me grupmoshën 75–85 vjeç, rrespektivisht 60 përqind dhe 55.2 përqind (Tabela 3.3 në shtojcë).

Pavarësisht nga rajoni gjeografik, duhanpirësit në zona urbane (72.4 përqind) dhe ata në zona rurale (67.1 përqind) konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë. Niveli i edukimit nuk duket se bënë dallim në intensitetin e konsumimit të duhanit, pasi që më shumë se 60 përqind e duhanpirësve në secilën kategori të arsimit pohojnë se konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë (Tabela 3.3 në shtojcë). Sa i përket të ardhurave, grupi i duhanpirësve që fitojnë më shumë se 1,600 euro për muaj (duke qenë grupi me të ardhurat më të larta) paraqet përqindjen më të ulët (43.7 përqind) të atyre që konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë, ndërsa duhanpirësit me të ardhura nga 1,201–1,600 euro paraqesin grupin me përqindjen më të lartë (92.9 përqind) që konsumojnë më shumë se 20 cigare në ditë. Shiko më shumë detaje në Tabelën 3.3 në shtojcë.

### 3.3. FILLIMI I DUHANPIRJES NË BAZA DITORE

Mosha për fillimin e konsumimit të duhanit çdo ditë është raportuar vetëm për gjithmonë-duhanpirësit e përditshëm (ever-daily smokers). Në përgjithësi, gati gjysma e gjithmonë-duhanpirësve të përditshëm (45.0 përqind) e filluan pirjen e duhanit në baza ditore në mes të moshës 18 dhe 24, ndërsa 22.4 përqind e filluan duhanpirjen edhe më herët, në mes të moshës 16 dhe 17 vjeç. Bazuar në përgjigjet e responentëve, në shumicën e rasteve burrat dhe gratë janë bërë gjithmonë-duhanpirës të përditshëm gjatë moshës 18 deri në 24 vjeçare, respektivisht 42.9 përqind dhe 50.0 përqind. Për më tepër, shumica e gjithmonë-duhanpirësve të përditshëm kanë filluar konsumimin e duhanit çdo ditë ndërmjet moshës 18 dhe 24, pavarësisht nivelit të tyre të arsimimit. Për më shumë detaje shiko në Tabelën 3.4 në shtojcës.

Responentët të cilët kanë filluar duhanpirjen e përditshme para moshës 18 vjeçare, mesatarisht janë më pak të shkolluar (me nivel të mesëm shkollimi apo më pak). Në mesin e gjithmonë-duhanpirësve të përditshëm me të ardhurat më të ulëta (deri në 400 euro për muaj), 22.3 përqind e kanë filluar konsumimin e duhanit në moshën 13–15, përderisa 37.0 përqind e atyre me të ardhura më shumë se 1,600 euro për muaj kanë filluar duhanpirjen në një moshë relativisht më të vjetër prej 18 deri në 24, dhe 32.3 përqind e kanë filluar në mes të moshës 25 dhe 35. Shiko më shumë detaje në Tabelën 3.4 në shtojcë.



## 4. NDËRPRERJA E DUHANIT



### Mesazhet kyçe

- 1. Vetëm 16.1 përqind e duhanpirësve aktualë kanë bërë përpjekje për ta ndërprerë konsumimin e duhanit në 12 muajt e fundit dhe 54.1 përqind kanë abstenuar nga duhanpirja për vetëm një muaj.*
- 2. Arsyet shëndetësore janë faktori kryesorë për 64.7 përqind të duhanpirësve të cilët kanë bërë përpjekje për ta lënë duhanin.*
- 3. Vetëm 16.8 përqind e duhanpirësve aktualë konsumojnë më pak sesa në të kaluarën dhe 81.5 përqind e tyre veprojnë njëjtë për arsye shëndetësore.*

Ky kapitull paraqet të gjetura për aspekte të ndryshme të ndërprerjes së konsumimit të duhanit, duke përfshirë kohëzgjatjen e abstenimit nga duhanpirja, qëllimin e ndërprerjes sipas arsyeve dhe metodave, intensitetin e duhanpirjes në krahasim me të kaluarën, dhe arsyet për zvogëlimin e intensitetit të duhanpirjes.

### 4.1. RAPORTI I NDËRPRERJES SË DUHANIT

Raporti i ish-duhanpirësve ndaj duhanpirësve të përhershëm (e njohur si raporti i ndërprerjes) në Kosovë është 15.9 përqind (Tabela 4.1 në shtojcë). Raporti i ndërprerjes është paksa më i lartë për duhanpirësit burra (17.7 përqind), ndërsa ende më i lartë për duhanpirësit e moshave 55–64 dhe 65–74 vjeç (24.8 përqind dhe 42.0 përqind, respektivisht), dhe për duhanpirësit me të ardhura më të ulëta dhe më të larta (22.2 përqind dhe 26.7 përqind, respektivisht). Sa i përket duhanpirësve të përditshëm (raporti i ish-duhanpirësve të përditshëm ndaj duhanpirësve të përhershëm), raporti i ndërprerjes është 21.7 përqind.


### 4.2. PËRPJEKJET PËR TA NDËRPRERË DHE KOHËZGJATJA E ABSTENIMIT NGA KONSUMIMI I DUHANIT

Vetëm 16.1 përqind e duhanpirësve aktualë kanë bërë përpjekje për ta ndërprerë konsumimin e duhanit gjatë 12 muajve të fundit. Për më tepër, shumica e tyre (54.1 përqind) i janë rikthyer konsumimit vetëm pas një muaji (Figura 4.1).<sup>22</sup> Përqindja e abstenimit deri në tre muaj ishte më e lartë te gratë (35.4 përqind) sesa te burrat (27.0 përqind). Megjithatë, vetëm 11.6 përqind e duhanpirësve aktualë, të cilët u përpoqën ta ndërpresin konsumimin e duhanit, abstenuan për më shumë se gjashtë muaj ose më pak se një vit (përkatesisht 13.4 përqind për gra dhe 10.9 përqind për burra).

---

<sup>22</sup> Derisa 16.1 përqind e duhanpirësve (58 të rritur) raportuan se janë përpjekur ta ndërpresin konsumimin e duhanit në 12 muaj e fundit, vetëm 54 e të anketuarve mbanin në mend kohëzgjatjen e abstenimit nga duhani.


**Figura 4.1** Më shumë se gjysma e duhanpirësve aktualë të cilët janë përpjekur të heqin dorë nga pirja e duhanit i janë rikthyer pas vetëm një muaji (N=54)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Të gjithë duhanpirësit aktualë të cilët kanë bërë përpjekje ta ndërpresin konsumimin e duhanit në 12 muajt e fundit i përkasin moshës 18 dhe 74 vjeçare. Figura 4.2 tregon se përpjekjet për ndërprerje kanë qenë relativisht më dominante në tri grupmoshat më të reja (rreth 20 përqind) sesa në mesin e duhanpirësve mbi moshën 45 vjeç (më pak se 10 përqind). Më shumë se 50 përqind e duhanpirësve të moshës 18–44 vjeç të cilët u përpoqën ta ndërpresin konsumimin e duhanit iu rikthyen vetëm pas një muaji, përderisa ata ndërmjet moshës 45–54 menaxhuan të abstenojnë deri në gjashtë muaj. Abstenimi nga duhanpirja për më shumë se një muaj është vërejtur më shumë te duhanpirësit që jetojnë në zonat urbane (74.4 përqind) krahasuar me ata të zonave rurale (18.4 përqind) (Tabela 4.2 në shtojcë).

**Figura 4.2** Duhanpirësit më të rinjë kanë relativisht më shumë gjasa ta ndërpresin duhanin (N= 54)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Shumica e duhanpirësve me nivel shkollimi fillor apo më të ulët (67.8 përqind) dhe atyre me shkollim të mesëm (50.4 përqind) kanë qenë në gjendje ta ndërpresin duhanpirjen vetëm për një muaj, përdërisa më shumë se gjysma e duhanpirësve me nivel shkollimi universitar apo më të lartë e kanë ndërprerë duhanin deri në tre muaj (Tabela 4.2 në shtojcë).

#### 4.3. ARSYET E NDËRPRERJES SË DUHANPIRJES


Në shumicën e rasteve (66.0 përqind) shkaqet shëndetësore kanë qenë arsyet kryesore në përpjekjen për ta ndërprerë konsumimin e duhanit (Tabela 4.2a në shtojcë), ndërsa shumica e duhanpirësve (81.5 përqind) të cilët kanë bërë përpjekje për ta lënë duhanin nuk kanë përdorur ndonjë masë tjetër ndihmëse (Tabela 4.3b në shtojcë).

#### 4.4. NDRYSHIMI I INTENSITETIT NË KONSUMIMIN E DUHANPIRJES DHE ARSYET PËR ULJE TË KONSUMIT

Përdërisa 54.4 përqind e duhanpirësve aktualë konsumojnë numrin e njëjtë të cigareve si në të kaluarën, 28.8 përqind konsumojnë më shumë ndërsa vetëm 16.8 përqind e tyre konsumojnë më pak. Duhanpirësit burra kanë më shumë gjasë ta zvogëlojnë sasinë e duhanpirjes sesa gratë (20.4 përqind kundrejt 9.5 përqind). Duhanpirësit me të ardhurat më të larta (me të hyra në ekonomitë familjare me më shumë se 1,600 euro) përfaqësojnë përqindjen më të lartë të duhanpirësve që kanë zvogëluar intensitetin e duhanpirjes (29.1 përqind). Shiko më shumë detaje në Tabelën 4.4 në shtojcë.

Shumica e duhanpirësve aktualë, të cilët e kanë zvogëluar intensitetin e konsumimit të duhanit (81.5 përqind) vepruan kështu për shkaqe shëndetësore (Figura 4.3). Masat aktuale të kontrollit të duhanit, siç janë politikatat e duhanpirjes në ambiente të mbyllura, duket se nuk kanë ndikim të madhë në reduktimin e intensitetit të duhanpirjes, pasi që vetëm 1.4 përqind e duhanpirësve e kanë deklaruar këtë si arsye për zvogëlim të sasisë së konsumuar të duhanit.

**Figura 4.3** Shumica e duhanpirësve aktualë të cilët konsumojnë më pak duhan sesa më parë e bëjnë këtë për arsye shëndetësore (N=61)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 5. DUHANPIRJA PASIVE



### Mesazhet kyçe

- 1. Probabiliteti i ekspozimit ndaj duhanpirjes pasive në Kosovë është i lartë, pasi që 50.4 përqind e gjithë të rriturve (43.2 përqind e joduhanpirësve) i ekspozohen tymit të duhanit në shtëpi.**
- 2. Shumica e kosovarëve (91.2 përqind) i ekspozohen duhanpirjes pasive kryesisht në restorante, bare dhe klube të natës.**
- 3. Shumicës së përherë duhanpirësve (78.5 përqind) u është thënë së paku disa herë se tymi i tyre i duhanit i shqetëson të tjerët.**

Duhanpirja pasive ndodh atëherë kur joduhanpirësit thithin tymin e duhanit të shkaktuar nga duhanpirësit. Ky tym ka dy burime: njëra nga djegia e produkteve të duhanit dhe tjetra nga duhanpirësi. Një raport i OBSH-së tregon se asnjë vend/ambientë dhe kategori e popullatës nuk janë të përjashtuara nga dëmet e shkaktuara nga ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive.<sup>23</sup> Për më tepër, raporti i Surgeon General of the United States, thekson se duhanpirja pasive përmban kemikale të njëjta kancerogjene sikurse tymi që thithin duhanpirësit.<sup>24</sup>

Ekspozimi ndaj tymit të duhanit është i mundshëm në çdo vend, duke përfshirë shtëpitë, vendin e punës apo vendet publike, siç janë restorantet, kafiteritë, baret, klubet e natës, transporti publik, ndërtesat qeveritare, objektet shëndetësore, universitetet dhe shkollat. Ky seksion ofron një përmbledhje të të gjeturave mbi ekspozimin e të rriturve ndaj duhanpirjes pasive në Kosovë.

### 5.1. EKSPOZIMI NDAJ DUHANPIRJES PASIVE NË SHTËPI

Çdo i rritur në Kosovë (50.4 përqind) i ekspozohet tymit të duhanit në shtëpi, 58.0 përqind e duhanpirësve aktualë dhe 43.2 përqind e joduhanpirësve (Tabela 5.1 në shtojcë). Ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive në shtëpi është relativisht më e lartë në mesin e duhanpirësve aktualë gra sesa atyre burra (72.4 përqind kundrejt 51.1 përqind), përderisa nuk ka ndonjë dallim të madh gjinorë tek joduhanpirësit (44.8 përqind në mesin e grave dhe 38.3 përqind në mesin e burrave).

Ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive në shtëpi nuk ka dallim të madh në mes duhanpirësve aktualë në zonat urbane dhe rurale (58.9 përqind kundrejt 57.3 përqind), ndërsa joduhanpirësit në zonat rurale janë relativisht më të ekspozuar ndaj duhanpirjes pasive (46.2 përqind) krahasuar me zonat urbane (35.5 përqind). Pavarësisht statusit të duhanpirjes, çdo i rritur në grupmoshën prej 18–34 i ekspozohet duhanpirjes pasive, ndërsa një përqindje

<sup>23</sup> Öberg, M., S. Jaakkola, M., Prüss-Üstün, A., Schweitzer, C., & Woodward, A. (2010). Second-hand smoke: Assessing the burden of disease at national and local levels. (*Environmental Burden of Diseases Series, No. 18*). Marrë nga <https://bit.ly/3a55v9s>

<sup>24</sup> Xiques, P., & Reddick, V. (2006). The health consequences of involuntary exposure to tobacco smoke: Secondhand smoke, what it means to you (*Booklet, 2006 Surgeon General*). Marrë nga <https://bit.ly/3bd0NXm>

relativisht e madhe e joduhanpirësve në grupmoshën 35–64 nuk i ekspozohen duhanpirjes pasive (Tabela 5.1 në shtojcë).

Niveli i shkollimit dhe të hyrat e ekonomive familjare nuk kanë ndikim të madh në ekspozimin ndaj duhanpirjes pasive, pavarësisht statusit të duhanpirjes, përveç duhanpirësve me të ardhura prej më shumë se 1,600 euro për muaj dhe joduhanpirësve me nivel më të ulët se edukimi i mesëm. Shiko më shumë detaje në Tabelën 5.1 në shtojcë.

## 5.2. EKSPOZIMI NDAJ DUHANPIRJES PASIVE NË VENDET PUBLIKE


Të dhënat lidhur me ekspozimin ndaj duhanpirjes pasive në vendet publike janë mbledhur nga respondentët të cilët kanë vizituar vendet publike (30 ditë para intervistës) siç janë ndërtesat qeveritare, objektet shëndetësore, restorantet, kafiteritë, baret, klubet e natës, universitetet apo shkollat, si dhe transportin publik.

Përqindja më e lartë e respondentëve që janë ekspozuar duhanpirjes pasive në këto vende publike janë: në bare dhe klube të natës (91.2 përqind) dhe në restorante dhe kafiteri (69.2 përqind). Nivel i lartë i ekspozimit ndaj duhanpirjes pasive është raportuar në objektet shëndetësore dhe në universitete dhe shkolla (respektivisht 7.6 përqind dhe 9.6 përqind). Burrat krahasuar me gratë ka gjasë të jenë më të ekspozuar ndaj duhanpirjes pasive kur i vizitojnë këto vende publike, ndërsa për indikatorët tjerë nuk duket se ka dallime të mëdha. Shiko për më shumë detaje në Tabelën 5.2 në shtojcë.

## 5.3. QËNDRIMET NDAJ EKSPOZIMIT TË DUHANPIRJES PASIVE

Duhanpirësit aktualë dhe ish-duhanpirësit janë pyetur nëse i'u është thënë nga të tjerët se tymi që shkaktojnë nga duhanpirja i shqetëson të tjerët. Figura 5.1 tregon se 78.5 përqind e duhanpirësve të përhershëm raportuan se së paku disa herë i'u është thënë kjo gjë.

**Figura 5.1** Duhanpirësve të përditshëm shpesh u thuhet se duhanpirja e tyre i bezdisë të tjerët përreth (N=432)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 6. EKONOMIA



### Mesazhet kyçe

1. *Shuma mesatare e paguar për pako të 20 cigareve të prodhuara dhe për 20 cigare të mbështjella me dorë në Kosovë është 1.98 euro dhe 1.49 euro. Brendi më i konsumuar i cigareve të prodhuara është Winston, pasuar nga Lucky Strike dhe Marlboro.*
2. *Në përgjithësi, duhanpirësit aktualë të produkteve të duhanit shpenzojnë 17.3 përqind në muaj nga të hyrat familjare në cigare. Sa më të larta të ardhurat familjare dhe sa më i lartë niveli i arsimimit të duhanpirësve aktualë, aq më e ulët përqindja e buxhetit për konsumimin e produkteve të duhanit.*
3. *Rritja më e fundit në çmimin e cigareve nuk shkaktoi ndonjë ndryshim në veprime të 85.1 përqind të duhanpirësve në Kosovë, përveç të duhanpirësit e moshës 65 -74 dhe atyre me të ardhura nën 400 euro për muaj.*

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të aspekteve të përzgjedhura ekonomike të produkteve të duhanit, cigareve të prodhuara dhe të mbështjella me dorë, të konsumuara nga duhanpirësit aktualë. Lidhur me këtë, një numër indikatorësh janë analizuar, duke përfshirë konsumimin e përgjithshëm dhe çmimin e paguar për pako të cigareve të prodhuara dhe cigareve të mbështjella me dorë, shpenzimet javore dhe ato mujore, vendi ku janë blerë cigaret si dhe brendi i fundit i blerë nga duhanpirësit.


### 6.1. ÇMIMET E CIGAREVE

Figura 6.1 tregon se çmimi i përgjithshëm mesatar i paguar për një pako të cigareve të prodhuara (e përbërë nga 20 cigare) në Kosovë është 1.98 euro. Tabela 6.1 në shtojcë tregon se duhanpirësit burra dhe duhanpirësit e zonave urbane priren të konsumojnë cigare relativisht më të shtrenjta krahasuar me duhanpirëset gra dhe duhanpirësit e zonave rurale. Siç pritet, duhanpirësit më të vjetër dhe më pak të shkolluar priren të konsumojnë cigare më të lira, përderisa duhanpirësit me të ardhura të larta preferojnë cigare relativisht më të shtrenjta.

Sasia mesatare e paguar për 20 cigare të mbështjella me dorë është më e ulët krahasuar me 20 cigare të prodhuara, saktësisht 1.49 euro<sup>25</sup> (shiko Figurën 6.1). Tabela 6.1 në shtojcë tregon se duhanpirësit me të ardhura më të ulëta, me nivel më të ulët se shkollimi i mesëm, ata që jetojnë në zonat urbane dhe duhanpirësit e moshës 55 - 64 vjeçare, priren të konsumojnë cigare të mbështjella me dorë të cilat kanë çmim më të lirë.

<sup>25</sup> Për shkak të mungesës së të dhënave, autorët kanë përdorur vlerën e njësisë (shpenzimin për numrin e cigareve të mbështjella me dorë) për të kalkuluar çmimin e 20 cigareve të mbështjella me dorë.

**Figura 6.1** Në Kosovë çmimi mesatar për 20 cigare të prodhuara është më i lartë sesa për cigaret e mbështjella me dorë (N=349 për cigare të prodhuara, N=14 për cigare të mbështjella me dorë)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 6.2. SHPENZIMET PËR CIGARE


Figura 6.2 më poshtë tregon se 79.6 përqind e duhanpirësve aktualë shpenzojnë më pak se 100 euro në muaj për produktet e duhanit,<sup>26</sup> përderisa vetëm 0.5 përqind shpenzojnë nga 300 deri 344 euro. Shumica e duhanpirësve gra (94.6 përqind) shpenzojnë më pak se 100 euro për muaj në produkte të duhanit, ndërsa pjesa tjetër prej 5.4 përqind shpenzojnë prej 100-300 euro. Në anën tjetër, shumica e burrave (96.8 përqind) shpenzojnë deri në 200 euro në muaj për produkte të duhanit.

Shumica e duhanpirësve aktualë pavarësisht kategorive apo karakteristikave demografike shpenzojnë deri në 100 euro në muaj për produkte të duhanit, pasuar nga një pjesë tjetër shumë më e vogël, të cilët shpenzojnë deri në 200 euro. Siç pritet, 12.7 përqind e atyre me të ardhura më të larta (nga 1,201 deri 1,600 euro) shpenzojnë 300 deri 344 euro në muaj në produkte të duhanit (shiko Tabelën 6.2 në shtojcë).

<sup>26</sup> Produktet e duhanit tymosës përfshijnë cigare të prodhuara dhe cigare të mbështjella me dorë.



**Figura 6.2** Në përgjithësi, 79.6 përqind e duhanpirësve aktualë shpenzojnë më pak se 100 euro në muaj në produktet e duhanit<sup>27</sup> (N=357)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Për më tepër, Tabela 6.2.1 në shtojcë tregon se, mesatarja e përgjithshme e shpenzimeve mujore për cigare të prodhuara është 69.00 euro. Duhanpirësit burra shpenzojnë shumë më shumë se duhanpirëset gra, respektivisht 78.40 euro dhe 48.40 euro, përderisa duhanpirësit me të ardhura më të larta (1,201–1,600 euro) shpenzojnë një mesatare prej 102 euro për muaj. Në anën tjetër, shpenzimi mesatar mujor për cigare të mbështjella me dorë është 28.50 euro, dhe rezultatet nuk dallojnë shumë pavarësisht karakteristikave demografike.

Figura 6.2.1 tregon se mesatarja mujore e buxhetit të shpenzuar në produktet e duhanit nga duhanpirësit aktualë është 17.3 përqind. Ndërsa, kjo mesatare për cigaret e prodhuara është 17.1 përqind dhe për cigaret e mbështjella 9.5 përqind. Të dhënat gjithashtu tregojnë se, duhanpirësit burra, për cigaret e prodhuara dhe të mbështjella me dorë, shpenzojnë një përqindje më të lartë të buxhetit të tyre në produkte të duhanit krahasuar me gratë.

<sup>27</sup> Produktet e duhanit përfshijnë cigaret e prodhuara dhe cigaret e mbështjella me dorë pasi që shpenzimet e raportuara mujore përfshijnë vetëm këto dy lloje të cigareve.

**Figura 6.2.1** Duhanpirësit burra ndajnë përqindje relativisht më të lartë të buxhetit të tyre në cigaret e prodhuara dhe cigaret e mbështjella sesa duhanpirëset gra (N=258 për produkte të duhanit, N=250 për cigaret e prodhuara, N=9 për cigaret e mbështjella me dorë)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Për më tepër, Tabela 6.2.2 në shtojcë tregon se duhanpirësit aktual të moshës 75 deri 85 vjeç shpenzojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre mujore në produkte të duhanit (43.4 përqind), përdorin ata të moshës 18 deri 24 vjeç shpenzojnë shumë më pak (11.6 përqind). Duhanpirësit në zonat rurale alokojnë një pjesë relativisht më të madhe të të ardhurave të tyre në produkte të duhanit krahasuar me duhanpirësit nga zonat urbane, respektivisht 18.7 përqind dhe 15.6 përqind. Duhanpirësit më të arsimuar dhe me të ardhura ekonomike më të larta, shpenzojnë më pak në produkte të duhanit në baza mujore. Tabela 6.2.2 në shtojcë detajon më hollësisht shpenzimet mesatare mujore për cigaret e prodhuara dhe cigaret e mbështjella me dorë.

### 6.3. KONSUMIMI

Figura 6.3 paraqet numrin e cigareve të prodhuara dhe të mbështjella me dorë të konsumuara në ditë, në përgjithësi dhe sipas gjinisë. Numri mesatar i cigareve të prodhuara që konsumohen brenda ditës është 20.7 cigare, ndërsa nga perspektiva gjinore, burrat konsumojnë 23.6 cigare në ditë ndërsa gratë konsumojnë nëntë (9) cigare më pak se burrat. Tabela 6.3 në shtojcë ofron detaje të mëtutjeshme të konsumimit të cigareve sipas karakteristikave të ndryshme demografike.

**Figura 6.3** Duhanpirëset gra konsumojnë rreth nëntë cigare të prodhuara më pak se duhanpirësit burra (N=351 për cigaret e prodhuara, N=14 për cigaret e mbështjella me dorë)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë


Në anën tjetër, mesatarja e numrit të konsumuar të cigareve të mbështjella me dorë në ditë është 15.8 cigare, pa ndryshime të mëdha ndërmjet gjinive. Tabela 6.3 në shtojcë tregon se, duhanpirësit e moshës 55-74 vjeçare, konsumojnë mesatarisht 20 cigare të mbështjella me dorë në ditë. Duhanpirësit me më pak arsimim sesa shkollimi i mesëm, konsumojnë mesatarisht 18 cigare të mbështjella me dorë në ditë, ndërsa ata me nivel universitar nuk konsumojnë fare cigare të mbështjella me dorë. Sa më të larta të ardhurat në ekonominë familjare, më e ulët mesatarja e numrit të cigareve të mbështjella me dorë që konsumohen në ditë. Duhanpirësit me të ardhura mujore prej 801-1,200 euro, konsumojnë mesatarisht vetëm dy cigare të mbështjella me dorë në ditë, ndërsa ata me të ardhura mujore ndërmjet 401 dhe 800 euro, dhe më pak se 400 euro, konsumojnë 17.1 dhe 12.6 cigare të mbështjella me dorë në ditë.

#### 6.4. BRENDET E CIGAREVE

Figura 6.4 tregon pesë brendet më të blera apo konsumuara në Kosovë. Brendi më i konsumuar është Winston (22.1 përqind), ndjekur nga Lucky Strike (16.8 përqind), Marlboro (14.2 përqind), Ronson (7.5 përqind), dhe Rothmans (6.5 përqind). Këto pesë brende përbëjnë 67.1 përqind të të gjitha brendeve të konsumuara në Kosovë.

Winston (24.5 përqind), Lucky Strike (19.7 përqind), dhe Marlboro (16.0 përqind) janë shumë më të preferuara nga duhanpirësit burra, ndërsa Ronson (11.3 përqind) dhe Rothmans (9.3 përqind) blihen më shumë nga duhanpirëset gra (Tabela 6.4 në shtojcë). Winston, Marlboro, dhe Rothmans janë më të preferuara nga duhanpirësit e vendbanimeve urbane, ndërsa Lucky Strike dhe Ronson duken të jenë më të popullarizuara në zonat rurale.


**Figura 6.4** Brendet më të konsumuara të cigareve në Kosovë janë Winston, Lucky Strike, dhe Marlboro (N=349)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

Duhet theksuar se shumica e duhanpirësve aktualë në Kosovë janë shumë besnik ndaj brendeve të cilat i konsumojnë; 86.5 përqind gjithmonë e përdorin të njëjtin brend të cigareve të prodhuara (Figura 6.4.1). Pjesa e mbetur (13.5 përqind) konsumojnë brende tjera vetëm kur nuk kanë mundësi për ta blerë apo për ta gjetur brendin e tyre të preferuar ose kur dëshirojnë të provojnë diçka ndryshe, apo kur kanë më shumë para për të blerë cigaret e tyre të preferuara. Të gjeturat nuk ndryshojnë në mes të duhanpirësve burra dhe gra.

**Figura 6.4.1** Shumica e duhanpirësve aktualë janë shumë besnik ndaj brendeve të cilat i konsumojnë (N=349)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 6.5. VENDI I BLERJES

Figura 6.5 tregon se ku e kanë blerë për herë të fundit duhanpirësit aktual pakon e cigareve të prodhuara. Bazuar në përgjigjet e tyre shumica e duhanpirësve (92.0 përqind) e kanë blerë pakon e tyre të fundit të cigareve në dyqanet ushqimore, pasuar nga dyqanet e specializuara për shitjen e duhanit (4.2 përqind). Tabela 6.5 në shtojcë detajon tutje rezultatet sipas karakteristikave të ndryshme demografike.

**Figura 6.5** Në Kosovë cigaret e prodhuara më së shumti blihen në dyqane ushqimore (N=349)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 6.6. SJELLJA E DUHANPIRËSVE NDAJ NGRITJES TË ÇMIMIT


Rritja e fundit në taksën e akcizës në Kosovë është bërë në vitin 2019, saktësisht nga 45 euro në 47 euro për njësi (1,000 cigare), apo për 0.04 euro për pako e cila përmban 20 cigare.<sup>28</sup> Në të njëjtën kohë, çmimi për pako të cigareve të prodhuara është rritur mesatarisht për 0.1 euro. Lidhur me reagimin e duhanpirësve aktual, Figura 6.6 tregon se rritja paraprake e çmimit të cigareve të prodhuara nuk ka nxit ndonjë ndryshim të 85.1 përqind e duhanpirësve. Tabela 6.6 në shtojcë detajon tutje rezultatet sipas karakteristikave demografike. Gjithsesi, si pasojë e rritjes së çmimit të cigareve të prodhuara, duhanpirësit me të ardhura mujore familjare deri në 400 euro kanë konsumuar më pak cigare (10.6 përqind) ose ndonjë brend tjetër më të lirë (10.2 përqind).

Rritja e çmimit ndikoi relativisht më shumë te duhanpirësit e moshës 65 - 74 vjeçare, të cilët filluan të konsumojnë më pak cigare (13.8 përqind) apo brende më të lira (19.6 përqind). Sa i

<sup>28</sup> Sipas legjislacionit mbi taksat në Kosovë, akciza zbatohet vetëm për disa mallra vendore apo të importuara, duke përfshirë cigaret. Sipas kalendarit të akcizës, taksat e akcizës në duhan u rrit nga 41 euro në 2016 në 47 euro në 2019 për njësi konvencionale (1,000 cigare), apo për 2 euro në baza vjetore (Shiko: Vendimi i Qeverisë Nr. 11/64, datë: 16.12.2015, i disponueshëm në: <https://bit.ly/2VaYIZR>)

përket kategorive tjera, rritja e çmimit të cigareve nuk nxiti ndonjë ndryshim të madh në mesin e duhanpirësve.

**Figura 6.6** Për shumicën e duhanpirësve të cigareve të prodhuara, rritja e fundit e çmimeve të cigareve nuk nxiti (pati) ndonjë ndryshim <sup>29</sup> (N=266)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

<sup>29</sup> Asnjë respondent nuk raportoi kalim në cigare ilegale apo kontrabandë, kështu që kjo kategori nuk u raportua në shifra.

## 7. MEDIAT, QËNDRIMET DHE PERCEPTIMET



### Mesazhet kyçe

- 1. Reklamimi i duhanit në Kosovë është i rregulluar me ligj, gjë që shpjegon ekspozimin e ulët të qytetarëve ndaj marketingut të duhanit, pasi vetëm 2.5 përqind e të rriturve, kryesisht burra, kanë dëgjuar apo parë ngjarje të sponsorizuara nga brendet apo kompanitë e duhanit.**
- 2. Industria e duhanit në Kosovë kryesisht përdor promovimet siç janë dhuratat apo ofertat me zbritje speciale në produkte tjera gjatë blerjes së duhani (3.3 përqind) dhe veshje apo gjëra tjera me emër të brendit apo logo të cigareve (2.7 përqind).**
- 3. Rritja e çmimit të cigareve (31.1 përqind) dhe ilegalizimi i duhanpirjes dhe shitjes së produkteve të duhanit (33.9 përqind) perceptohen si politika të dobishme qeveritare për ta kontrolluar dhe kufizuar përdorimin e duhanit.**

Mediat gjithmonë kanë luajtur rol thelbësor në promovimin dhe rritjen e shitjes së produkteve të duhanit dhe për këtë qëllim mediat konsiderohen si mjet mjaft i rëndësishëm nga kompanitë e duhanit. Reklamimi, promovimi dhe sponsorizimi i duhanit është i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit (kapitulli IV), i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013.<sup>30</sup> Pavarësisht kësaj, zbatimi i ligjit mbetet i dobët. Ky kapitull prezanton të gjeturat që kanë të bëjnë me sponsorizimin dhe format tjera të promovimit të produkteve të duhanit, qëndrimet kundrejt çmimit të cigareve, si dhe përfitimet e politikave kundër duhanit.

### 7.1. PROMOVIMI I DUHANIT


Figura 7.1 më poshtë tregon se, gjatë gjashtë muajve të fundit, vetëm 2.5 përqind e të rriturve kanë parë apo dëgjuar rreth ngjarjeve të sponsorizuara nga kompanitë e duhanit ose brendet e cigareve, saktësisht 3.2 përqind e burrave dhe 1.8 përqind e grave. Për më tepër, Tabela 7.1 në shtojcë tregon se, individët të cilët kanë parë apo dëgjuar ngjarje të sponsorizuara nga brendet e cigareve ose kompanitë e duhanit janë kryesisht duhanpirës aktualë dhe persona që nuk kanë konsumuar asnjëherë duhan.<sup>31</sup>

Tabela 7.1.1 në shtojcë tregon numrin dhe përqindjen e shpërndarjes së të rinjve, të cilët kanë vërejtur një nga nëntë promovimet e duhanit gjatë gjashtë muajve të fundit. Përderisa vetëm 2.5 përqind e të rriturve kanë parë apo dëgjuar rreth ngjarjeve të sponsorizuara nga brende të cigareve ose kompani të duhanit, 3.3 përqind e të rriturve kanë vërejtur dhurata apo oferta me zbritje speciale në produktet tjera në rastet kur kanë blerë cigare, dhe 2.7 përqind kanë parë veshje apo gjëra tjera me emër apo logo të brendeve të cigareve.

<sup>30</sup> Gazeta Zyrtare Ligji Nr. 04/L-156 PËR KONTROLLIN E DUHANIT. Marrë nga <http://bit.ly/33emngg>

<sup>31</sup> Asnjëherë duhanpirës janë të rriturit të cilët nuk kanë provuar asnjëherë të konsumojnë duhan apo e kanë provuar një herë apo disa herë, por jo vazhdimisht.

**Figura 7.1** Vetëm 2.5 përqind e të rriturve kanë parë apo dëgjuar rreth ngjarjeve të sponsorizuara apo që lidhen me brende apo kompani të duhanit (N= 998)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 7.2. QËNDRIMET NDAJ ÇMIMIT TË CIGAREVE

Figura 7.2 tregon se 70.1 përqind e të rriturve e konsiderojnë çmimin e cigareve si të “shtrenjtë” ose si “shumë të shtrenjtë”. Tabela 7.2 në shtojcë tregon se gratë i perceptojnë çmimet e cigareve si më të shtrenjta krahasuar me burrat. Pavarësisht statusit të duhanpirjes, shumica e respondentëve e perceptojnë çmimin e cigareve si të shtrenjtë apo shumë të shtrenjtë. Shumica e atyre me të ardhura mujore mbi 1,600 euro e perceptojnë çmimin aktual si adekuat ose si të shtrenjtë.

**Figura 7.2** Shumica e të rriturve e perceptojnë çmimin e cigareve si të shtrenjtë apo si “shumë të shtrenjtë” (N=998)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë




### 7.3. RITJIA E ÇMIMIT TË CIGAREVE PËR PESË PËRQIND

Figura 7.3 tregon përqindjen e respondentëve të cilët pajtohen dhe nuk pajtohen me rritje të çmimit të cigareve prej pesë përqindë. Në përgjithësi, 41.9 përqind e respondentëve janë fuqishëm kundër një rritjeje të tillë, ndërsa 28.2 përqind janë fuqishëm në favor të saj.

Tabela 7.3 në shtojcë tregon se shumica e duhanpirësve (67.2 përqind) janë fuqishëm kundër rritjes së çmimit të cigareve, ndërsa vetëm 7.9 përqind janë pro. Në anën tjetër, 41 përqind e personave që nuk kanë konsumuar asnjëherë duhan dhe 29.5 përqind e ish-duhanpirësve janë fuqishëm në favor të një rritjeje prej pesë përqind. Gratë, të rriturit me një nivel shkollimi universitar, dhe ata me të ardhura më të ulëta janë relativisht më të prirur për të mbështetur rritjen e çmimit të cigareve për pesë përqind (Tabela 7.3.1 në shtojcë).

**Figura 7.3** Më shumë se 40 përqind e të rriturve janë fuqishëm kundër rritjes së çmimit të cigareve prej pesë përqind (N=998)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

### 7.4. RITJIA E ÇMIMIT TË CIGAREVE PËR 20 PËRQIND

Rezultatet e paraqitura në Figurën 7.4 paraqesin përgjigjet e respondentëve krahas rritjes së çmimit të cigareve prej 20 përqind. Në përgjithësi, 51.2 përqind e respondentëve janë fuqishëm kundër një rritje të çmimit prej 20 përqind, përderisa 25.3 përqind e tyre janë në favor të saj.

Tabela 7.4 në shtojcë tregon se, 79.5 përqind e duhanpirësve aktual janë fuqishëm kundër një rritje të çmimit prej 20 përqind, ndërsa vetëm 6.9 përqind e tyre janë pro kësaj rritje. Në ndërkohë 40.6 përqind e ish-duhanpirësve dhe 34.3 përqind e personave që asnjëherë nuk kanë konsumuar duhan janë kundër rritjes së çmimit prej 20 përqind. Për më tepër, gratë, të moshuarit që jetojnë në zonat rurale dhe ata me nivel shkollimi universitar janë pro rritjes së çmimit të cigareve prej 20 përqind (Tabela 7.4.1 në shtojcë).

**Figura 7.4** Afërsisht 60 përqind e të rriturve janë jashtëzakonisht ose mesatarisht kundër rritjes së çmimit të cigareve prej 20 përqind (N=998)




Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 7.5. DOBIA E POLITIKAVE KUNDËR DUHANIT

Figura 7.5 krahason perceptimet e respondentëve karshi dy masave të kontrollit ndaj duhanit: çmime më të larta për produktet e duhanit dhe ilegalizimin e duhanpirjes dhe shitjes së duhanit. Derisa shumica e të rriturve nuk janë në favor të rritjes prej pesë përqind të çmimit të cigareve, nga ana tjetër, më shumë se 50 përqind e të rriturve thonë se çmimet më të larta apo ilegalizimi i përdorimit të duhanit dhe shitjes së tij, do të ishin politika më të dobishme për ta zvogëluar duhanpirjen.

Duhet përmendur që duhanpirësit aktualë krahas ish-duhanpirësve dhe atyre që nuk kanë pirë asnjëherë duhan, i perceptojnë këto dy politika kundër duhanit si shumë të dobishme (Tabela 7.5 në shotjçë). Megjithatë, politikat tjera të kontrollit të duhanit, përkatësisht, ofrimi i mbështetjes falas për të ndërprerë duhanin, zgjerimi i hapësirave ku ndalohet duhani, si dhe kufizimi i dyqaneve ku shiten produktet e duhanit, konsiderohen kryesisht si të padobishme nga ish-duhanpirësit dhe personat që asnjëherë nuk e kanë filluar duhanpirjen.

**Figura 7.5** Rritja e çmimit të cigareve dhe përfshirja e pirjes së duhanit si veprimtari ilegale perceptohen si politikat më të dobishme kundër duhanit (N=998)



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e STC-SEE për Kosovë

## 8. KONKLUZION

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se, në Kosovë prevalenca e duhanpirjes (36.4 përqind) dhe intensiteti i duhanpirjes në mesin e të rriturve janë shumë të larta. Këto të gjetura mund t'i shërbejnë Qeverisë së Kosovës si bazë për të mbështetur dizajnimin e masave më efektive në kontrollin e duhanit apo fillimin e iniciativave të reja në këtë drejtim, si dhe të vlerësojë zbatimin e ligjeve në fuqi, në veçanti të Ligjit për Kontrollin e Duhanit. Për më tepër, ky raport ofron të dhëna thelbësore dhe analizë të thellë lidhur me indikatorët e duhanpirjes në Kosovë si për politikbërësit ashtu edhe për avokuesit e shëndetit publikë, drejt zhvillimit të politikave për ta frenuar konsumimin e duhanit. Të gjeturat mund të përdoren për t'i identifikuar mundësitë në parandalimin dhe zvogëlimin e konsumimit të duhanit, por edhe për t'i përshpejtuar iniciativat kundër përdorimit të duhanit në përgjithësi.

Duhani konsumohet me të madhe në Kosovë dhe kjo sigurisht ka pasoja ekonomike dhe shëndetësore. Të gjeturat tregojnë se, pavarësisht gjinisë, moshës, banimit, nivelit të edukimit apo të ardhurave, më shumë se 50 përqind e duhanpirësve konsumojnë më shumë se një pako prej 20 cigaresh në ditë. Kjo në mënyrë të konsiderueshme ndikon në buxhetin e ekonomive familjare, veçanërisht të atyre që nuk qëndrojnë mirë në aspektin ekonomik (me të hyra deri në 400 euro për muaj), pasi mesatarisht, 17.3 përqind e të hyrave mujore të ekonomive familjare shpenzohen në produkte të duhanit.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i analizave të tjera, për ta kuptuar në mënyrë më gjithëpërfshirëse çështjen e përdorimit të duhanit në Kosovë, konsiderohen si shumë të nevojshme.

### **Rekomandime**

1. Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë të konsiderueshme ta rrisë taksën e akcizës, pasi kjo ndikon në zvogëlimin e konsumimit të cigareve në Kosovë.
